



KodListë
-- Përkufizimi -- Një kombinim midis matjes së burimit dhe treguesit të burimit.
-- Emri -- Burimet të matura, të përcaktuara dhe të nxjerra
-- Përkufizimi -- Një kombinim i matjes së burimit, treguesit të burimit dhe burimit të nxjerrë.
-- Emri -- Minerali tregues dhe i nxjerrë
-- Përkufizimi -- Një kombinim i treguesit të burimit dhe burimit të nxjerrë.
-- Emri -- Mangësi dokumentacioni
-- Përkufizimi -- Vlerësuar ose dokumentuar me mangësi në dokumentacion.

4.2.14 VLERAT E LLOJIT TË VENDBURIMIT MINERAL

Emri: Vlerat e llojit të vendburimit mineral

Përkufizimi: Vlerat që tregojnë mënyrën se si paraqitet minerali ose vendburimi.

Përshkrimi: Termi i përdorur është lokal/rajon, prandaj zakonisht drejtohem i për shpjegime nëpër grupet e caktuara për terminologji për vendburimet minerale, ku janë skemat lokale dhe rajonale.

Vlera shtesë: Secili

Identifikuesi: <http://inspire.ec.europa.eu/codelist/MineralDepositTypeValue>

Vlerat: Vlerat e lejuara për këtë kodlistë përfshijnë çdo vlerë të përcaktuar nga ofruesi i të dhënave.

Për më shumë informacion rreth përdorimit të VleratELlojitTëVendburimitMineral është në dispozicion:

<http://www.earthresourceml.org>

VENDIM

Nr. 998, datë 9.12.2020

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT “STANDARDET SHETETËRORE PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFORMACIONIT GJEOPHAPËSINOR NË SHQIPËRI – TEMA: INFRASTRUKTURA URBANE DHE SHËRBIMET QEVERTARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2, shkronja “nj”, e 16, pika 1, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendës-kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – tema: Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin e përditësimin e të dhënave gjeohapësinore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



STANDARDET SHITETËRORE
PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË
INFORMACIONIT GJEOPHËSINOR NË
SHQIPËRI – TEMA: INFRASTRUKTURA
URBANE DHE SHËRBIMET QEVERTARE

PËRMBAJTJA

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

2. HYRJE

2.1 Qëllimi

2.2 Si lexohet dokumenti

2.3 Detyrimet ligjore

2.4 Fusha e veprimit

3. TEMA

3.1 Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare

3.1.1 Parathënie

3.1.2 Përmbajtja dhe struktura e të dhënave

3.2 Përshkrimi i nëntemës “Shërbimet qeveritare administrative dhe sociale”

3.2.1 Skemat e aplikimit dhe diagramet UML për nëntemën “Shërbimet qeveritare administrative dhe sociale”

3.2.2 Katalogu i tipologjisë

3.2.2.1 Shërbimet qeveritare

3.2.2.2 Lloji i zonës përgjegjëse

3.2.2.3 Lloji i vendndodhjes së shërbimit

3.2.2.4 Vlera e llojit të shërbimit

3.3 Përshkrimi i nëntemës “Objektet e menaxhimit mjedisor”

3.3.1 Skemat e aplikimit dhe diagramet UML për nëntemën: “Objektet e menaxhimit mjedisor”

3.3.2 Katalogu i tipologjisë

3.3.2.1 Objektet e menaxhimit mjedisor

3.3.2.2 Vlerat e llojit të objekteve të menaxhimit mjedisor

3.4 Përshkrimi i nëntemës “Rrjeti i infrastrukturës inxhinierike”

3.4.1 Përshkrimi i nëntemës “Elementet e përbashkët”

3.4.1.1 Skemat e aplikimit dhe diagramet UML për nëntemën “Elementet e përbashkët”

3.4.1.2 Katalogu i tipologjisë

3.4.1.2.1 Aksesor

3.4.1.2.2 Elementet e rrjetit të infrastrukturës inxhinierike

3.4.1.2.3 Kabinë

3.4.1.2.4 Kabllo

3.4.1.2.5 Kasetë

3.4.1.2.6 Kuti shpërndarëse/kolektori i infrastrukturës inxhinierike

3.4.1.2.7 Lidhje rrjeti

3.4.1.2.8 Pusetë

3.4.1.2.9 Nyjë e infrastrukturës inxhinierike

3.4.1.2.10 Rrjet i infrastrukturës inxhinierike

3.4.1.2.11 Sekuencat e rrjeteve të infrastrukturës inxhinierike

3.4.1.2.12 Shtyllë

3.4.1.2.13 Konstruksion metalik

3.4.1.2.14 Struktura e lidhjeve të infrastrukturës inxhinierike

3.4.1.2.15 Tub

3.4.1.2.16 Vlerat e llojeve të aksesorëve të rrjetit

3.4.1.2.17 Vlerat e llojeve të rrjeteve të infrastrukturës inxhinierike

3.4.1.2.18 Vlerat e llojit paralajmërues

3.4.1.2.19 Vlerat e llojit të shpërndarjes së infrastrukturës inxhinierike

3.4.1.2.20 Vlerat e llojit të aksesorëve specifik

3.4.2 Përshkrimi i nëntemës “Rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike”

3.4.2.1 Skemat e aplikimit dhe diagramet UML për nëntemën: “Rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike”

3.4.2.2 Katalogu i tipologjisë

3.4.2.2.1 Kabllo elektrike

3.4.2.2.2 Vlerat e llojit të aksesorëve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike

3.4.3 Përshkrimi i nëntemës “Rrjeti i shpërndarjes së kanalizimeve”

3.4.3.1 Skemat e aplikimit dhe diagramet UML për nëntemën “Rrjeti i shpërndarjes së kanalizimeve”

3.4.3.2 Katalogu i tipologjisë

3.4.3.2.1 Kanalizime

3.4.3.2.2 Vlerat e llojit të ujërave të ndotura

3.4.3.2.3 Vlerat e llojit të aksesorëve të rrjetit të shpërndarjes së ujërave të ndotura

3.4.4 Përshkrimi i nëntemës “Rrjeti i shpërndarjes së naftës, gazit dhe kimikateve”

3.4.4.1 Skemat e aplikimit dhe diagramet UML për nëntemën “Rrjeti i shpërndarjes së naftës, gazit dhe kimikateve”

3.4.4.2 Katalogu i tipologjisë

3.4.4.2.1 Tubat e naftës, gazit dhe kimikateve

3.4.4.2.2 Vlerat e llojit të aksesorëve të rrjetit të shpërndarjes së naftës, gazit dhe kimikateve



3.4.4.2.3 Vlerat e llojeve të produkteve të rrjetit të shpërndarjes së naftës, gazit dhe kimikateve

3.4.5 Përshkrimi i nëntemës “Rrjeti i shpërndarjes së telekomunikacionit”

3.4.5.1 Skemat e aplikimit dhe diagramet UML për nëntemën: “Rrjeti i shpërndarjes së telekomunikacionit”

3.4.5.2 Katalogu i tipologjisë

3.4.5.2.1 Kablllo telekomunikacioni

3.4.5.2.2 Vlerat e llojit të materialit kabllor të telekomunikacionit

3.4.5.2.3 Vlerat e llojit të aksesorëve të rrjetit të shpërndarjes së telekomunikacionit

3.4.6 Përshkrimi i nëntemës “Rrjeti i shpërndarjes së energjisë termike”

3.4.6.1 Skemat e aplikimit dhe diagramet UML për nëntemën “Rrjeti i shpërndarjes së energjisë termike”

3.4.6.2 Katalogu i tipologjisë

3.4.6.2.1 Tub termik

3.4.6.2.2 Vlerat e llojeve të aksesorëve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë termike

3.4.7 Përshkrimi i nëntemës “Rrjeti i shpërndarjes së sistemit ujqor”

3.4.7.1 Skemat e aplikimit dhe diagramet UML për nëntemën “Rrjeti i shpërndarjes së sistemit ujqor”

3.4.7.2 Katalogu i tipologjisë

3.4.7.2.1 Tub ujq

3.4.7.2.2 Vlera e llojit të ujqit

3.4.7.2.3 Vlera e llojeve të aksesorëve të rrjetit të shpërndarjes së sistemit ujqor

3.5 Cilësia e të dhënave

3.5.1 Kompletimi – Komisioni (*Completeness – Commission*)

3.5.2 Kompletimi – Përfshirimi (*Completeness – Omission*)

3.5.3 Përfshirja logjore – Përfshirja konceptuale (*Logical consistency – Conceptual consistency*)

3.5.4 Përfshirja logjore – Përfshirja me domenin (*Logical consistency – Domain consistency*)

3.5.5 Përfshirja logjore – Përfshirja me formatin (*Logical consistency – Format consistency*)

3.5.6 Përfshirja logjike – Përfshirja topologjike (*Logical consistency – Topological consistency*)

3.5.7 Saktësia pozicionale – Saktësia absolute ose jashtme (*Positional accuracy – Absolute or external accuracy*)

3.5.8 Saktësia pozicionale – Saktësia relative ose e brendshme (*Positional accuracy – Relative or internal accuracy*)

3.5.9 Saktësia tematike – Korrektësia e klasifikimit (*Thematic accuracy – Classification correctness*)

3.5.10 Saktësia tematike – Korrektësia e attributeve josasiore (*Thematic accuracy – Nonquantitative attribute correctness*)

3.5.11 Saktësia tematike – Korrektësia e attributeve sasimore (*Thematic accuracy – quantitative attribute correctness*)

3.5.12 Cilësia e kohës – Saktësia e matjes së kohës (*Temporal quality – Accuracy of a time measurement*)

3.5.13 Cilësia e kohës – Kohëzgjatja e qëndrueshmërisë (*Temporal quality – Temporal consistency*)

4.1 Aneksi A – Katalogu i tipologjisë

4.2 Aneksi B – Kodlistat

4.2.1 Skema e aplikimit “Shërbimet qeveritare administrative dhe sociale”

4.2.1.1 Vlerat e llojit të shërbimeve

4.2.2 Skema e aplikimit “Objektet e menaxhimit mjedisor”

4.2.2.1 Vlerat e llojit të objekteve të menaxhimit mjedisor

4.2.3 Skema e aplikimit “Elementet e përbashkët”

4.2.3.1 Vlerat e llojit të shpërndarjes së infrastrukturës inxhinierike

4.2.3.2 Vlerat e llojeve të rrjeteve të infrastrukturës inxhinierike

4.2.3.3 Vlerat e llojit paralajmërues

4.2.4 Skema e aplikimit “Rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike”

4.2.4.1 Vlerat e llojit të aksesorëve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike

4.2.5 Skema e aplikimit “Rrjeti i shpërndarjes së naftës, gazit dhe kimikateve”

4.2.5.1 Vlerat e llojit të aksesorëve të rrjetit të shpërndarjes së naftës, gazit dhe kimikateve

4.2.5.2 Vlerat e llojeve të produkteve të rrjetit të shpërndarjes së naftës, gazit dhe kimikateve

4.2.6 Skema e aplikimit “Rrjeti i shpërndarjes së kanalizimeve”



4.2.6.1 Vlerat e llojit të aksesorëve të rrjetit të shpërndarjes së ujërave të ndotura

4.2.6.2 Vlerat e llojit të ujërave të ndotura

4.2.7 Skema e aplikimit “Rrjeti i shpërndarjes së energjisë termike”

4.2.7.1 Vlerat e llojeve të aksesorëve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë termike

4.2.8 Skema e aplikimit “Rrjeti i shpërndarjes së sistemit uxor”

4.2.8.1 Vlerat e llojit të aksesorëve të rrjeti i shpërndarjes të sistemit uxor

4.2.8.2 Vlerat e llojit të ujërave

4.2.9 Skema e aplikimit “Rrjeti i shpërndarjes së telekomunikacionit”

4.2.9.1 Vlerat e llojit të aksesorëve të rrjetit të shpërndarjes së telekomunikacionit

4.2.9.2 Vlerat e llojit të materialit të kabllove të telekomunikacionit

1. Përshkrimi i standardeve

Ky dokument përmban standardet e specifikimeve teknike të të dhënave gjeohapësinore për ndërtimin e NSDI, duke u mbështetur në direktivën INSPIRE. Autori i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) në bashkëpunim me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit (AZHT), e cila është autoritet publik përgjegjës për temën: “Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare”.

Data e publikimit të versionit nr. 1, është dhjetor 2018. Emërtimi i dokumentit është: ASIG_Standard_NSIDI_2018_IUSHQ_v.1 ku:

ASIG – Autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit;

Standard – Lloji i dokumentit;

NSDI – Qëllimi i dokumentit;

2018 – Viti i krijimit;

IUSHQ – Tema për të cilën është krijuar standardi: “Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare”, e cila i referohet temës “*Utility and Government Services*” të direktivës INSPIRE;

v.1 – Numri i versionit të standardit.

2. HYRJE

2.1 Qëllimi

Ky dokument përcakton specifikimet teknike, të harmonizuara konform direktivës INSPIRE, për të dhënat gjeohapësinore të temës “Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare”, temë e cila është përcaktuar në nenin 11, pika 2/nj, të ligjit nr. 72/2012 “Për

organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

Ky dokument publikohet si standard që përcakton rregullat bazë të implementimit të NSDI⁴ në Shqipëri, me qëllim përdorimin e tij nga autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, që të arrihet një kuptueshmëri unike dhe korrekte e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore, për të realizuar ndërveprueshmërinë e tyre.

2.2 Si lexohet dokumenti

2.2.1 Struktura e dokumentit

Ky dokument është i organizuar në katër kapituj kryesorë:

1. Përshkrimi i standardeve: Në këtë pjesë jepet emërtimi dhe autori i standardeve.

2. Hyrje: Në këtë pjesë jepen përshkrime dhe shpjegime për të kuptuar mënyrën si organizohet i gjithë informacioni dhe si mund të interpretohet më lehtë ai.

3. Tema: Në këtë pjesë jepen specifikimet teknike për temën “Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare”.

4. Aneks: Në këtë pjesë jepen informacione shtesë, shpjeguese, në ndihmë të përdoruesve, si dhe jepen të detajuara vlerat e kodlistave.

- Përmbajtja e kapitullit të 3-të është strukturuar në 7 pjesë kryesore:

3.1 Përshkrimi i temës: Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e temës, si dhe mënyrën e konceptimit të temës në nëntemat e mëposhtme.

3.2 Përshkrimi i nëntemës së parë: Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e nëntemës “Shërbimet qeveritare dhe sociale”, si dhe detajohen diagramet UML dhe katalogu i tipologjive.

3.3 Përshkrimi i nëntemës së dytë: Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e nëntemës- “Objektet e menaxhimit mjedisor” si dhe detajohen diagramet UML dhe katalogu i tipologjive.

3.4 Përshkrimi i nëntemës së tretë: Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e nëntemës “Rrjeti i infrastrukturës inxhinierike”.

⁴ NSDI – Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Gjeohapësinor.



Në këtë nëntemë trajtohen elementet e infrastrukturës inxhinierike sipas rrjeteve si dhe detajohen diagramet UML dhe katalogu i tipologjive për secilin rrjet.

3.5 Metadata: Këtu jepen specifikimet teknike për metadatat e temës përkatëse.

3.6 Sistemi Koordinativ Referencë: Këtu përcaktohet sistemi koordinativ referencë që është miratuar me vendimin nr. 669, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar me vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 322, datë 27.4.2016 dhe nr. 359 datë 29.5.2019.

3.7 Cilësia e të dhënave: Këtu jepet një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementeve dhe matjes së tyre.

2.2.2 Diagramet UML dhe katalogu i tipologjisë

Diagramet UML ofrojnë një mënyrë të shpejtë për të parë elementet kryesore të specifikimeve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Përkufizimi mbi llojin e objektit gjeohapësinor,

atributet dhe marrëdhëniet janë të përfshira në ‘*Katalogun e tipologjive*’ (*Feature Catalogue*). Personat të cilët kanë ekspertizë tematike, por nuk janë të familjarizuar me UML-në, mund ta kuptojnë plotësisht përmbajtjen e modelit të të dhënave duke u fokusuar te ‘*Katalogu i tipologjive*’. Për përdoruesit e aplikacioneve ‘*Katalogu i tipologjive*’ mund të jetë i dobishëm për të kontrolluar nëse ai përmban të dhëna të nevojshme për përdorim.

Në tabelat e mëposhtme shpjegohet përmbajtja dhe mënyra e organizimit të informacionit, në tabelat e të dhënave, në ‘*Katalogun e tipologjive*’.

Tabelat nr. 1, 2, me anë të shembujve, shpjegojnë mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e tipologjive dhe të attributeve të tyre.

Tabela nr. 3, me anë të një shembulli, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e kodlistës.

Tabela 1

Emri - Emërtimi i tipologjisë	
Përkufizimi	Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE për tipologjinë.
Përshkrimi	Shënime dhe përshkrime të tjera për tipologjinë.
Lloji i tipologjisë	Tipi i elementit që mund të jetë i këtyre llojeve: «featureType» - një element që mund të jetë real, në terren, apo një dukuri abstrakte; «dataType» - një element tabelor, që shërben vetëm si tabelë attributesh, për t'u lidhur me një element tjetër; «enumeration» «CodList» - listë e parapërgatitur vlerash ku elementi duhet të marrë vlerë. <i>Enumeration</i> nënkupton “renditje vlerash”, ndërsa <i>codeList</i> nënkupton listë vlerash ose ndryshe “kodlistë”. Në dokument gjenden të shqipëruara si “Numërtimet dhe kodlistat”; «union» - një mbulesë topologjike e dy ose më shumë grupeve të të dhënave gjeohapësinore, që ruan tiparet që bien brenda shtrirjes gjeohapësinore të të dy grupeve të të dhënave hyrëse; «Imported» - të dhëna të specifikuar në tema të tjera të direktivës INSPIRE. Në dokument gjenden “Të dhënat e importuara”.
Gjeometria	Gjeometria e elementit sipas formatit vektor mund të gjendet në tri forma: pikë, linjë, poligon. Abstrakt - kur elementi nuk është element real në terren, por konsiderohet vetëm si dukuri.
Shumëllojshmëria	Lloji dhe numri i vlerave që mund të marrë atributi: 0..* - mund të marrë shumë lloje vlerash ose asnjë vlerë; 1..* - mund të marrë minimumi 1 vlerë ose shumë vlera; 0..1 - mund të mos marrë asnjë vlerë ose nëse merr vlerë, duhet të marrë vetëm 1 vlerë të vetme; 1 - duhet të marrë detyrimisht 1 vlerë.
I detyrueshëm	Po – nëse atributi është i detyrueshëm të plotësohet; Jo – nëse atributi nuk është i detyrueshëm të plotësohet.
Rol shoqërimi	Në tabelën e lidhjeve “Rol shoqërimet” tregohen marrëdhëniet hierarkike ndërmjet elementeve të ndryshme në këtë temë, si dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML.



Tabela 2

ATRIBUTET
-- Emri -- Emërtimi i atributit -- Përkufizimi -- Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementeve. -- Përshkrimi -- Shënime dhe përshkrime të tjera për elementin [I detyrueshëm: Detyrueshmëria nëse atributi duhet të marrë vlerë, p.sh: PO]

Tabela 3

ATRIBUTET
Vlera e parë e listës së gatshme, p.sh: ligjor -- Emri -- Emërtimi i vlerës -- Përkufizimi -- Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE i elementeve.
Vlera e dytë (etj.) e listës së gatshme, p.sh: joligjor -- Emri -- Emërtimi i vlerës -- Përkufizimi -- Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE i elementeve.

2.2.3 Karakteristikat e voidable dhe shumëllojshmëria

Stereotipi voidable përdoret për të përshkruar ato karakteristika të objekteve gjeohapësinore që mund të jenë ose mund të mos jenë të pranishme në grupet e të dhënave gjeohapësinore edhe pse mund të ekzistojnë në realitet. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet t'u jepet një vlerë.

Për të gjitha karakteristikat e përcaktuara për objektet gjeohapësinore duhet të paraqitet një vlerë – ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave), ose vlera 'void'. Një vlerë void nënkupton që nuk ekziston një vlerë përkatëse në grupet e të dhënave gjeohapësinore që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese.

Arsyeja e përdorimit të vlerës void duhet të paraqitet kurdo që të jetë e mundur duke përdorur një nga vlerat e listuara në kodlistën VleraArsyesëPavlefshmërisë

(VoidReasonValue), e cila përmban:

- E panjohur (Unknown)

-- Përkufizimi --

Vlera korrekte për këtë element gjeohapësinor nuk njihet ose është e pamatshme nga krijuesi i të dhënave.

-- Përshkrim --

Shembull: Kur "kuota e sipërfaqes së një trupi ujon nga niveli i detit" e një liqeni të caktuar, nuk është matur, atëherë arsyeja e pavlefshmërisë së kësaj karakteristike mund të jetë "E panjohur".

- E papopulluar (Unpopulated)

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë nuk është pjesë e databazës së mirëmbajtur nga krijuesi i të dhënave. Pavarësisht kësaj kjo e dhënë mund të ekzistojë.

-- Përshkrimi --

Shembull: Kur "kuota e sipërfaqes së një trupi ujon nga niveli i detit" nuk është e përfshirë në grupin e të dhënave që përmban objektin gjeohapësinor të liqenit, atëherë vlera e kësaj karakteristike mund të jetë "E pa populluar".

- Konfidenciale (Withheld)

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë mund të ekzistojë por është konfidenciale.

-- Përshkrimi --

Shembull: Të dhënat personale të popullsisë, të cilat ekzistojnë, por që nuk mund të shfaqen

pasi mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Stereotipi voidable nuk jep asnjë informacion nëse ekziston një karakteristikë në realitet. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristikë mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në realitet, vlera minimale do të përcaktohet si 0. P.sh. nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria e përkatesisë përkatese do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në realitet, vlera minimale do të përcaktohet si 1. P.sh. nëse një njësi administrative ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria e përkatesisë përkatese do të jetë 1..*.

2.2.4 Mbulimet - Coverages

Funksionet e mbulimit “Coverages” përdoren për të përshkruar karakteristikat e një fenomeni të botës reale që zhvillohet në kohë dhe/ose hapësirë. Shembuj tipik të tyre janë temperaturat, lartësitë, imazheritë etj. Një mbulim përmban një grup vlerash, të cilat shoqërohen me një element gjeohapësinor, kohor, kohor-gjeohapësinor. Domein-et tipike gjeohapësinore janë grupe pikash (p.sh. vendndodhja e sensorëve), kurbat përcaktuese (p.sh. izolinjat), rrjetet (p.sh. ortoimazheria, modelet e lartësive) etj.

Në skemat e aplikimit të INSPIRE, funksionet e mbulimit janë përcaktuar si veti të

llojeve të objekteve gjeohapësinore, ku lloji i vlerës së kësaj karakteristike është një realizim i një prej llojeve të specifikuar në SSH EN ISO 19123:2007.

Për të përmirësuar përputhjen me standardet e mbulimit në nivelin e zbatimit (p.sh. ISO 19136 dhe OGC Shërbimi i Mbulimit në Internet) dhe për të përmirësuar harmonizimin ndërtematik për përdorimin e mbulimeve në INSPIRE, një skemë e aplikimit për llojet e mbulimit është përfshirë në Modelin Konceptual të Përgjithshëm “Generic Conceptual Model”.

Kjo skemë aplikimi përmban llojet e mëposhtme të mbulimit:

- RrjetiIMbulimitIKorrigjuar (rektifikuar): Mbulimi, domein-i i të cilit përbëhet nga një rrjet i korrigjuar, një rrjet për të cilin ka një transformim përfundimtar midis koordinatave të rrjetit dhe koordinatave të sistemit koordinativ referencë (shih figurën 1, majtas).

- RrjetiIMbulimitReferencë: Mbulimi, domein-i i të cilit përbëhet nga një rrjet referimi - një rrjet i lidhur me një transformim, që mund të përdoret për të kthyer vlerat e koordinatave të rrjetit në vlera të koordinatave të referuara në një sistem referimi koordinativ (shih figurën 1, djathtas).

Aty ku është e mundur përdoren vetëm këto lloje mbulimi (ose një nëntip i tyre) në skemat e aplikimit në INSPIRE.




Figura 1: Shembuj të një rrjeti të korrigjuar (majtas) dhe të një rrjeti referues (djathtas)

2.2.5 Numërtimet dhe kodlistat (Enumeration and codlist)

Kodlistat modelohen si klasa në skemat e aplikimit, por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit. Në kodlistë, termi ‘vlera të tjera’ përcakton llojin e përmbajtjes së kodlistës, e përcaktuar specifikisht si më poshtë:

- ‘jo’ përfaqëson kodlista që përmbajnë vetëm vlera të specifikuar në këtë dokument;

- ‘të kufizuara’ përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuar në këtë dokument dhe vlera të tjera të limituara, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave;



- ‘të hapura’ përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuar në këtë dokument dhe vlera shtesë në çdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave;

- ‘po’ përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

Vlerat shtesë, të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave, nuk duhet të zëvendësojnë apo të modifikojnë vlerat ekzistuese të përcaktuara në dokument.

Në rastin kur ofruesit e të dhënave do të përdorin kodlista me vlera “jo”, pra të specifikuar në dokument, ofruesit janë të detyruar t’i bëjnë këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistrë. Kjo do të mundësojë që edhe përdoruesit e tjerë t’i kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi t’i përdorin.

2.2.6 Paraqitja e dimensionit kohor

Skemat e aplikimit përdorin atributin “FillimiICiklitJetësor” dhe “PërfundimiICiklitJetësor” për të regjistruar jetëgjatësinë e një objekti gjeohapësinor.

Atributi “FillimiICiklitJetësor” specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Atributi “PërfundimiICiklitJetësor” specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në realitet.

Ndryshimet që bëhen në atributin “PërfundimiICiklitJetësor” nuk shkaktojnë ndryshime në atributin “FillimiICiklitJetësor”.

❖Shënim i rëndësishëm:

Disa terma në ‘Katalogun e tipologjive’, si p.sh: *featureType*, *dataType*, *Void*, *Coverages* etj., nuk janë përkthyer qëllimisht në gjuhën shqipe. Qëllimi parësor është që të mos humbasin kuptimin gjatë përkthimit dhe së dyti, të përdoret një gjuhë unike sipas termave të direktivës INSPIRE.

2.3 Detyrimet ligjore

Në bazë të nenit 16, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, ASIG-u është përgjegjës për krijimin e standardeve për secilën nga temat e përcaktuara në ligj (neni 11), në përputhje me standardet evropiane (direktiva INSPIRE).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinore, për krijimin e NSDI-së në Shqipëri, janë përshtatur nga specifikimet teknike të temave përkatëse në direktivën INSPIRE, si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare që mbështesin dhe bazohen në këtë direktivë. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të zbatojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore.

Standardet (Rregullat e implementimit - IR) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

- **Metadata** – në këtë fushë direktiva përcakton standardet se si duhen të jenë metadatat. Ky standard është unik dhe i

aplikueshëm për të gjitha institucionet ose palët e treta (siç është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilët do të implementojnë atë (VKM-ja nr. 1077, datë 23.12.2015);

- **Specifikimi i të dhënave** – standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme që do të publikohen, INSPIRE ka përcaktuar disa attribute bazë të cilat do të shërbejnë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose të nevojave të brendshme, mund të shtojnë attribute të tjera për t’i bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen, duhet të jenë të dokumentuara dhe të miratuara nga institucionet përgjegjëse lokale.

2.4 Fusha e veprimit

Të gjithë autoritetet publike, kompanitë private apo individë që mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të institucioneve publike, janë të detyruar t’i nënshtrohen këtij standardi.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga direktiva INSPIRE ka proceset dhe ciklin jetësor, si më poshtë:




Figura 2: Proceset e ciklit jetësor

Planifikimi – Është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave;

Vlerësimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do të jetë certifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënat që të përshtaten me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit;

Procesimi (Përpunimi) – Është procesi gjatë të cilit mbledhen dhe modifikohen atributet e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuara gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi janë bashkësi të dhënash gati për t'u publikuar;

Shpërndarja – Është procesi gjatë të cilit të dhënat vihen në dispozicion për përdoruesit (qytetarët, autoritetet publike, organizatat ose palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, të përdorë, të analizojë ose të citojë të dhëna. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit;

Zbulimi – Është proces i vazhdueshëm gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jociësore në të dhënat e publikuara;

Analiza – Është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë

këtij procesi merret vendimi çfarë do të bëhet me të dhënat që janë evidentuar;

Përditësimi – Është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces regjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe atyre të publikuara;

Arkivimi – Është procesi gjatë të cilit bashkësitë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesohen, arkivohen, duke u bazuar në standarde lokale dhe në legjislacionin në fuqi të vendeve ku implementohet. Rezultat i këtij procesi janë të dhënat që bëhen të pa aksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen për arsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose me standardet specifike;

Shkatërrimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat bëhen të parikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde lokale ose në legjislacionin në fuqi.

3. TEMA

3.1 Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare

3.1.1 Parathënie

Tema “Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare” përfshin elemente të ndryshëm si: rrjetet e ndryshme energjetike, shërbimet publike (lokale dhe qendrore) të llojeve të ndryshme dhe disa facilitete të menaxhimit mjedisor.



Përkufizim:

Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare përshkruan shërbime të tilla si: menaxhimin e mbetjeve, furnizimin me energji dhe furnizimin me ujë, ujërat e ndotura, shërbimet qeveritare, administrative dhe sociale, siç janë administratat publike, vendstrehimet e mbrojtjes civile, shkollat dhe spitalet.

Përshkrimi:

Kjo temë ofron informacion bazë (p.sh. vendndodhjen, karakteristikat themelore teknike ose palët e përfshira) në një gamë të gjerë shërbimesh administrative dhe sociale me interes publik.

Kjo temë është e ndarë në nëntemat e mëposhtme:

- Rrjetet e infrastrukturës inxhinierike: rrjetet e infrastrukturës inxhinierike të strukturuar, të grumbullimit, transmetimit dhe shpërndarjes përfshirë rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, rrjetin e shpërndarjes së naftës/gazit dhe kimikateve (tokë, det), rrjetin e shpërndarjes së ujësjellës - kanalizimeve, rrjetin e shpërndarjes së telekomunikacionit, rrjetin e transportit ajror, rrugor dhe hekurudhor, rrjetin termik;

- Shërbimet qeveritare administrative dhe sociale: shërbimet qeveritare dhe infrastruktura sociale, të përzgjedhura në lidhje me fushëveprimin e INSPIRE (të përqendruar në aspektet publike dhe mjedisore), të përfaqësuara si “pika interesi”;

- Objektet e menaxhimit mjedisor: përshkrimet e përgjithshme të objekteve për zonat e menaxhimit të mbetjeve, impiantet e trajtimit të ujit dhe zonat e rregulluara ose të paligjshme për hedhjen e mbetjeve.

Rrjetet e infrastrukturës inxhinierike

Rrjetet dhe shërbimet e infrastrukturës inxhinierike përfshijnë: ndërtimet fizike për transportin e produkteve të përcaktuara të shërbimeve (si: tubacionet për transportin e naftës, gazit, kimikateve, ujit, kanalizimit dhe produkteve termike), linjat dhe kabllot e transmetimit (përfshirë ato për transmetimin e energjisë elektrike, p.sh. stacionet e pompave). Ato janë të lidhura me pajisje për prodhimin dhe trajtimin e llojeve të ndryshme të shërbimeve (p.sh. stacionet e pompave) dhe elementet e tjerë të rrjetit për mbylljen e tubave dhe modeleve (p.sh. kasetë, shtyllat dhe kullat).

Ndër rrjetet më të rëndësishme dallojmë:

- Rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike;

- Rrjetin eshpërndarjes së naftës, gazit dhe kimikateve;

- Rrjetin e shpërndarjes së kanalizimeve;

- Rrjetin e shpërndarjes së ujësjellësit;

- Rrjetin e shpërndarjes së telekomunikacionit;

- Rrjetin termik;

- Rrjetin e sistemit ujor.

Të gjitha këto rrjete përdorin modelin e nyjë-hark-nyjë, siç përcaktohet në modelin e rrjetit të përgjithshëm. Kjo paraqitje, jep një model të strukturuar të rrjeteve të infrastrukturës inxhinierike dhe lejon përdorimin e saj nga bizneset (vlerësimi i përhapjes, llogaritjes së kapaciteteve, etj.). Përdorimi i këtij moduli nyjë-hark-nyjë përshtatet gjithashtu për të dhënat jotopologjike, por mbetet fakultativ. Institucionet/organizatat kanë përgjegjësi të ndryshme dhe kjo ndikon në llojin e të dhënave që mbledhin, menaxhojnë dhe përdorin. Ato, sipas kërkesave, përdorin modele të thjeshta ose më komplekse. Ky specifikim i të dhënave bazohet në një kuadër që përdoruesi, mund të përdori dhe nëse është e nevojshme të përshtatet. Specifikimi fokusohet në objektet bazë gjeohapësinore të kërkuara nga rrjetet, domethënë lidhjet e rrjetit etj.

Rrjetet e infrastrukturës inxhinierike dhe shërbimet përdorin kanalet që kryejnë lidhjet me shërbimet dhe mbrojnë, udhëzojnë kabllot dhe tubacionet nëpërmjet një ndërtimi të mbyllur. Kaseta mund të përmbajë kaseta, tubacione dhe kabllot të tjera. Kaseta përmban informacion rreth pozicionit dhe karakteristikave. Nyjat e rrjeteve përfshijnë shtylla, të cilat përfaqësojnë objekte nyjash që mbështesin pajisjet dhe kabllot e shërbimeve. Shtyllat janë në funksion të objekteve të tjera të infrastrukturës inxhinierike. Nyjë të tjera të rëndësishme janë pusetat, shtyllat e tensionit/kullat dhe kabina.

Një pusetë e thjeshtë që mund të përmbajë objekte të vetme ose të shumëfishta të rrjeteve të shërbimeve. Shtyllë tensioni/kullë e thjeshtë, që mund të mbajë elemente të shërbimeve që i përkasin ose rrjeteve të vetme ose të shumëfishta. Kabina mund të mbajë objekte të shërbimeve që i përkasin rrjetave të vetme ose të shumëfishta të shërbimeve. Këto objekte janë shumë të rëndësishme dhe për rrjete të tjera.

Lidhja me temat e tjera:

- Hidrografia;

- Ndërtesat;



- Përdorimi i tokës;

- Infrastruktura për monitorimin e mjedisit (si impiantet e trajtimit/stacionet e pompimit);

- Infrastruktura industriale;

- Burimet energjetike.

Shërbimet qeveritare, administrative dhe sociale

Shërbimet qeveritare administrative dhe sociale, siç janë administratat publike, vendstrehimet e mbrojtjes civile, shkollat, spitalet. Llojet e vendeve që zakonisht paraqiten në portalet qeveritare dhe në sistemet e hartave si “pika të interesit”, mund të jenë vendndodhje me pikë bazë të një sërë kategorish të shërbimeve qeveritare të infrastrukturës inxhinierike. Shumëllojshmëria e mënyrave se si ofrohen shërbimet publike dhe shumëllojshmëria e menaxhimit të objekteve, si dhe aktiviteti i njëkohshëm i organeve të ndryshme të administratës publike, përbëjnë gjithë rrjetin e gjerë të përdorimit të këtyre shërbimeve.

Disa shërbime, ofrohen si pasojë e ndonjë katastrofe mjedisore si: stuhi, përmbajtje, etj. Ky aspekt mbulohet nga tema “Zonat me rreziqe natyrore” dhe rrjedhimisht janë jashtë këtij specifikimi të të dhënave. Nuk ka rëndësi nëse shërbimi ofrohet nga një organ i administratës publike/sociale apo dhe nga një institucion privat. Kjo ndryshon nga shteti në shtet, qytet, fshat ose njësi administrative. Përveç kësaj, ka shumë shërbime publike ku qëllimi kryesor i të cilit nuk është që të ofrojë shërbime në ngjarjet e fatkeqësive mjedisore, por mund të përdoret në këto situata, si sallat e sporteve etj.

Objektet e menaxhimit mjedisor

Kjo nëntemë përfshin disa kategori me qëllim identifikimin e objekteve mbrojtëse mjedisore. Kategoritë, si p.sh: zonat e trajtimit të mbetjeve, impiantet e trajtimit të mbetjeve, zonat e rregulluara dhe të paligjshme për hedhjen, mbetjet minerale dhe ujërat e zeza, përmenden si kategori që duhet të përfshihen. Rastet e përdorimit gjithashtu tregojnë nevojën për të siguruar informacion mbi trajtimin, grumbullimin dhe asgjësimin e mbetjeve.

Për këtë arsye, fushëveprimi i nëntemës përfshin të gjitha objektet e përfshira dhe/ose të kërkuara me ligj për t’u regjistruar në menaxhimin e të gjitha llojeve të mbetjeve të “Katalogut Evropian të Mbetjeve dhe Listës së Mbetjeve të Rrezikshme”. Vendndodhjet jepen me pikë ose me poligon. Këto vende kuptohen si një njësi stacionare ku kryhen një ose më shumë aktivitete të menaxhimit të

mbetjeve, ose aktivitete të tjera të lidhura drejtpërdrejtë.

Vendndodhja kuptohet si një vend i vetëm, në të cilin zhvillohen veprimtaritë e menaxhimit të mbetjeve. Objekti i menaxhimit mjedisor, i shprehur si aktivitet ekonomik (zakonisht si aktiviteti i menaxhimit të mbetjeve), hyrjet/daljet dhe rezultatet. Përveç kësaj, informacioni për orët e punës dhe kapacitetet janë gjithashtu të lidhura me objektin, si dhe operatorët, pronarët, kontaktet dhe autoritetet kompetente. Aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve dallohen sipas kategorive të tilla si: magazinimi, rikuperimi dhe/ose hedhja e mbetjeve.

Lidhja dhe varësia me temat e tjera:

- Korniza referuese gjeodezike KRGJSH (referenca e pikave);

- Sistemet e rrjeteve gjeografike (gjeoreferencimi i pikës);

- Emërtimet gjeografike (Identifikimi i pikave dhe i vendit ku ndodhet);

- Njësitë administrative (që përmbajnë pikën);

- Sistemet e adresave (referenca e pikës);

- Parcelat kadastrale (që përmbajnë shërbimin e dhënë dhe nga e cila ofrohet shërbimi);

- Rrjetet e transportit (që ofrojnë qasje në/nga shërbimet) vende të mbrojtura (që mund të përmbajnë shërbime ose të jenë receptorë potencial të tyre);

- Modeli digjital i terrenit (referenca e pikave);

- Njësitë statistikore (që përmbajnë pikën);

- Ndërtesat (shërbim);

- Demografia/shpërndarja e popullsisë (shërbimi i mundshëm).

Përdorimi i të dhënave gjeohapësinore

Disa nga rastet e përdorimit të këtyre të dhënave jepen, si më poshtë:

- Raportimi i informacionit për vendndodhjen dhe gjendjen e tubacioneve të rrjeteve të infrastrukturës inxhinierike si: tubacionet naftës/jellëse/gazsjellëse, tubacionet e sistemeve ujore, tubacionet e ujërave të ndotura/kanalizime, linjat e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe linjat e shpërndarjes së sinjalit të telekomunikacionit;

- Informacionet e përpunuara përdoren nga institucionet e administratës publike si: shërbimi policor, zjarrfikësit, spitalet, azilet, shkollat/kopshtet, si dhe nga instanca të tjera qeveritare;

- Menaxhimi i emergjencave;

- Planifikimi i shërbimeve qeveritare;

- Hartografimi i të dhënave p.sh harta e informacionit territorial;

- Parandalon keq menaxhimin e mbetjeve.

3.1.2 Përmbajtja dhe struktura e të dhënave

Shërbimet qeveritare, administrative dhe sociale janë ndarë në tri paketa kryesore, të cilat zhvillohen më poshtë. Pavarësisht koncepteve të përbashkëta në lidhje me temën (të tilla si: lokalizimi, përshkrimi teknik dhe pala përgjegjëse), trajtohen të ndara, ku secila përmban nga një skemë aplikimi. Kjo është kryesisht për shkak të vëzhgimit që ofruesit e të dhënave dhe përdoruesit e të dhënave për secilën nëntemë janë pothuajse të ndryshme.

Gjithashtu, është vendosur që të mos zbatohet një modelim i mbulimit, gridit, në këtë fazë të zhvillimit të specifikimit të të dhënave, për faktin se nëse mbulime të tilla ekzistojnë, ato ndikojnë në rezultatet e analizës gjeohapësinore (p.sh. qasja në rrjetet e telekomunikacionit - GSM, 3G, etj.), më shumë sesa në informacionin e vërtetë (p.sh. pozicioni i antenave).

Ky specifikim i të dhënave përcakton skemat e mëposhtme të aplikimit:

- Shërbimet qeveritare, administrative dhe sociale:

Skema e aplikimit të “Shërbimeve qeveritare dhe shërbimeve sociale” ofron informacion në lidhje me vendndodhjen dhe llojin e shërbimeve administrative dhe sociale të qeverisë.

- Objektet e menaxhimit mjedisor:

Skema e aplikimit “Objektet e menaxhimit mjedisor” mbështet informacionin për praktikën e

trajtimit dhe ruajtjes së mbetjeve, si dhe aktivitete të tjera mjedisore.

- Rrjeti i infrastrukturës inxhinierike:

Skemat e aplikimit të “Rrjeteve të infrastrukturës inxhinierike” bazohen në një strukturë të një-hark-nyjë dhe konceptin e rrjetit (që rrjedh nga modeli i rrjetit gjenerik). Përkatësisht trajtohen gjashtë lloje të rrjeteve të infrastrukturës inxhinierike (energji elektrike, kimikate e naftë-gazit, ujore, kanalizime, termike dhe telekomunikacioni).

Profil i Rrjeteve të infrastrukturës inxhinierike përmban skemat e mëposhtme të aplikimit:

- Skema e aplikimit “Elementet e përbashkët të rrjetit të infrastrukturës inxhinierike” që përmban elemente të përbashkët për të gjitha rrjetet tematike;

- Skema e aplikimit “Rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike” që përmban elementet e përbashkët për domein-in e energjisë elektrike;

- Skema e aplikimit “Rrjeti i shpërndarjes së naftës-gazit-kimikateve” që përmban elementet e përbashkët për fushën e naftës, gazit dhe kimikateve;

- Skema e aplikimit “Rrjeti i shpërndarjes së telekomunikacionit” që përmban elementet e përbashkët për fushën e telekomunikacionit;

- Skema e aplikimit “Rrjeti termik” që përmban elementet e përbashkët për domein-in termik;

- Skema e aplikimit “Rrjeti i sistemit ujor” që përmban elementet e përbashkët për fushën e ujërave.




Figura 4: Skema e aplikimit dhe përmbledhja e kritereve të “Shërbimeve administrative dhe qeveritare”



3.2 Përshkrimi i nëntemës “Shërbimet qeveritare administrative dhe sociale”

Skema e aplikimit “Shërbimet qeveritare, administrative dhe sociale” konsiston në klasën ShërbimetQeveritare, llojet e të dhënave të lidhura, klasat e bashkuara, si dhe kodlistat.

Atributet e detyrueshme të klasës ShërbimeQeveritare janë InspireId, vendi ku ofrohet shërbimi (VendndodhjaEShërbimit) dhe lloji i shërbimit (LlojiIShërbimit). Vendndodhja e shërbimit (atributi VendndodhjaEShërbimit) mund të modelohet në mënyra të ndryshme, kështu që siguresit e të dhënave mund të zgjedhin alternativën më të përshtatshme. Nëse shërbimet janë të lokalizuara brenda ndërtesave ose komplekseve për aktivitete, gjeometria e shërbimit duhet të sigurohet si një referencë për këto karakteristika. Disa vende shërbimi janë të vendosura jashtë ndërtesave ose komplekseve të aktivitetit, por ata kanë një adresë (p.sh. vendi i uljes për helikopterët e shpëtimit). Pastaj referenca gjeohapësinore duhet të ndahet nga adresa. Në raste të veçanta, vendndodhja e shërbimit përkon me një element rrjeti, i cili gjithashtu mund të përdoret si referencë gjeohapësinore. Vendndodhja e shërbimit mund të sigurohet nga një gjeometri.

Lloji i shërbimit përcaktohet nga një kodlistë (VleratELlojitTëShërbimit). Baza është klasifikimi COFOG (Klasifikimi i funksioneve të qeverisë) nga Eurostat [COFOG 1999]. Ky klasifikim mbulon një gamë të gjerë shërbimesh administrative dhe sociale qeveritare, por ofron kryesisht një model për statistikat në lidhje me shpenzimet qeveritare. Prandaj COFOG (Klasifikimi i funksioneve të qeverisë) nuk mund të përdoret pa modifikim, lista është përshtatur dhe rafinuar sipas llojeve, të cilat bazohen në kërkesat e nxjerra nga legjislacioni, rastet e përdorimit dhe intervistat. Kodlista është e organizuar në mënyrë hierarkike. Për të përcaktuar hierarkinë brenda kodlistës, vlera

burimore është përmendur në tabelën e kodlistës. Për të qenë të plota, nënpjesët e kodlistës të lidhura me fushën e arsimit, përfshijnë evoluimin e fundit të ISCED (Klasifikimi standard ndërkombëtar i arsimit) që ka ndodhur në 2011.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet domethënia e çdo artikulli, duhet të merret jo vetëm nga emri, përkufizimi apo përshkrimi, por gjithashtu edhe nga pozicioni i saj brenda hierarkisë. Lloji “ShërbimetQeveritare” është (element fiktiv - për shkak se nuk është pjesë e listës) element rrënjësor i pemës (paraqitje të dhënash). Të dyja nyjat (p.sh. shërbimi për mbrojtjen nga zjarri) dhe pjesët përbërëse (p.sh. stacionet e zjarrfikëses) mund të përdoren si lloje shërbimesh. Pema është qëllimisht e pa balancuar.

Atributet e mëtejshme të ShërbimitQeveritar janë të stereotipit voidable. Përveç fillimit/përfundimit të FillimitTëCiklitJetësor, të cilat i referohen ciklit jetësor të një versioni të objektit gjeohapësinor (digjital), tipi i elementit në versionin kryesor të tij përmban atributin PikaEKontaktit dhe ZonaEPërgjegjesisë. PikaEKontaktit (tipi i të dhënave Kontakt nga GCM) siguron informacione të kontaktit me qëllim që të ketë qasje në një shërbim dhe/ose informacion fillestar në lidhje me një shërbim.

Atributi ZonaEPërgjegjesisë përmban përgjegjësinë gjeohapësinore të një shembulli shërbimi, p.sh. të një administrate ose stacioni policor.

Ky informacion thjeshtëson identifikimin e vendndodhjes së duhur të shërbimit për përdoruesit. Referenca gjeohapësinore mund të sigurohet ose nga një NjësiAdministrative, një VendIEmërtuar, një AktivitetKompleks ose gjeometri (klasë bashkimi).

3.2.1 Skemat e aplikimit dhe diagramet UML për nëntemën “Shërbimet qeveritare administrative dhe sociale”



Figura 5: Diagrami i përgjithshëm e klasës së Shërbimeve qeveritare administrative dhe sociale

Paraqitja gjeometrike

Siç përshkruhet dhe shpjegohet në modelin UML më sipër, shembuj të tipologjisë *ShërbimeQeveritare*, mund të modelohen duke përdorur disa lloje të referencave gjeohapësinore ose çdo lloj gjeometrie (lloji i gjeometrisë *GM_Gjeometri*) në mënyrë që të mos detyrohet asnjë MS apo prodhues të dhënash për të futur ndryshime, në mënyrën se si ata modelojnë dhe ruajnë grupet e të dhënave origjinale.

Meqë kjo skemë e aplikimit është e fokusuar në shërbime (dhe jo në objektet gjeohapësinore ku shërbimet janë të lokalizuara), rekomandohet fuqimisht që të mos jepen gjeometri të tjera si pika. Qëllimi për të përdorur tipin e të dhënave *GM_Objekt* në skemën e aplikimit është që të lehtësojë përpjekjet për ofruesit e dhënave, nëse gjeometria ruhet me lloje të tjera të dhënash.

Kur referenca gjeohapësinore e një shërbimi administrativ dhe social qeveritar ofrohet nga një gjeometri autonome, atëherë të dhënat duhet të modelohen si objekte pika (lloji i gjeometrisë: *GM_Pikë*).

3.2.2 Katalogu i tipologjisë

3.2.2.1 Shërbimet qeveritare

-- Emri --

Shërbimet qeveritare

-- Përkufizimi --

Shërbimet qeveritare administrative dhe sociale, siç janë administratat publike, vendstrehimet e mbrojtjes civile, shkollat dhe spitalet publike ose private. Kjo shtrirje përcaktohet në vlerat e shërbimit të kodlistës korresponduese *LlojiVlerës*.

-- Përshkrimi --

Pozicionet e përcaktuara zakonisht paraqiten në portalet qeveritare, bashkiake dhe në sistemet e hartave si “pikë interesi”, mund të jenë të dhëna të bazuara në pika të ndryshme të shërbimeve bashkiake, qeveritare dhe infrastruktura sociale. Lloji i objektit gjeohapësinor është i përgjithshëm në aspektin e paraqitjes së modelimit, lloji konkret i *ShërbimetQeveritare* përcaktohet nga vlera e atributit *LlojiShërbimit*.

-- Tipi i elementit --

FeatureType



ATTRIBUTE

Fillimi[Ciklit]etësor: Data

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Fillimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --

Data dhe koha në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është futur ose ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore.

-- Përshkrimi --

Lidhur me ciklin jetësor të objektit gjeohapësinor në grupin e të dhënave.

[I detyrueshëm: PO]

InspireId: Identifikues

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

InspireId

-- Përkufizimi --

Identifikues i objektit të jashtëm të shërbimit qeveritar.

-- Përshkrimi --

Shënim. Një identifikues i objektit të jashtëm është një identifikues i veçantë i objektit, i publikuar nga organi përgjegjës, i cili mund të përdoret nga aplikacionet e jashtme për të referuar objektin gjeohapësinor. Identifikuesi është një identifikues i objektit gjeohapësinor, jo një identifikues i fenomenit të botës reale.

[I detyrueshëm: PO]

LlojiLSërbimit: VleratELlojitTëShërbimit

Shumëllojshmëria: [1]

